


UDHËZUES MBI “ ELEMENTËT PËR NJOHJE NGA ANA E
KMR,PËR PERSONAT JURIDIKE E FIZIKË QË KRYEJNË
MATJE ME RREZATIMET JONIZUESE DHE
JOJONIZUESE, KALIBRIM TË PAJISJEVE
RADIOMETRIKE DHE MATËSE TË RREZATIMEVE,
TRAJNIME, DHE SHËRBIMIN E DOZIMETRISË
PERSONALE ”


Në mbështetje të Ligjit Nr. 8025, datë 09.11.1995 “ Për Mbrojtjen nga Rrezatimet Jonizuese”, i ndryshuar, neni 9 ,pika 2, rregullores Nr. 591, datë 18/8/2011, miratuar me VKM, “Për nivelet e lejuara të përqëndrimit të radonit në ndërtesa dhe ujë, nivelet udhëzuese të radiobërthamave në materialet e ndërtimit, si dhe nivelet e lejuara të radiobërthamave në ushqime dhe produktet kozmetike”, neni 6 ,pika2 Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet në mbledhjen

Nr. 1526/1 Datë 13.04.2012

VENDOSI:

1. Miratimin e udhëzuesit mbi “Elementët për njohje nga ana e KMR-së për personat juridikë e fizikë që kryejnë matje me rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese, kalibrim të pajisjeve radiometrike dhe matëse të rrezatimeve, trajnime, dhe shërbimin e dozimetrisë personale” sipas tekstit të mëposhtëm.
 2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.


Miratohet
Kryetari i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet
Ministër i Shëndetësisë
PetrIT VASILI


Sekretari
Rustem PACI

UDHËZUES MBI “ ELEMENTËT PËR NJOHJE NGA ANA E
KMR, PËR PERSONAT JURIDIKË E FIZIKË QË KRYEJNË
MATJE ME RREZATIMET JONIZUESE DHE
JOJONIZUESE, KALIBRIM TË PAJISJEVE
RADIOMETRIKE DHE MATËSE TË RREZATIMEVE,
TRAJNIME DHE SHËRBIMIN E DOZIMETRISË
PERSONALE ”

UDHËZUES MBI “ ELEMENTËT PËR NJOHJE NGA ANA E
KMR, PËR PERSONAT JURIDIKË E FIZIKË QË KRYEJNË
MATJE ME RREZATIMET JONIZUESE DHE
JOJONIZUESE, KALIBRIM TË PAJISJEVE
RADIOMETRIKE DHE MATËSE TË RREZATIMEVE,
TRAJNIME DHE SHËRBIMIN E DOZIMETRISË
PERSONALE ”

Nga këndvështrimi i standarteve, cilësia e procesit të provave, analizave dhe matjeve, mbështetet mbi konformitetin me kërkesat e standarteve në fushën e menaxhimit dhe sigurimit të cilësisë. Për të siguruar një konformitet thelbësor dhe jo formal me standartet, kërkohet një njohje si dhe eksperiencë. Në mbështetje të gadishmërisë dhe aplikimit të kriterëve të përshtatshme procedurale që janë të domosdoshme në zbatimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, të zotërimit të instrumentave për përdorimin e parashikuar, një faktor themelor është kompetenca e personelit të punësuar. Matjet e sakta, standartet dokumentare dhe vlerësimi i konformitetit janë bërë kushte për zgjerimin e bizneseve. Organizmat që mund të njihen janë ato që kryejnë aktivitete të përcaktuara si vlerësime konformiteti. Këto aktivitete përfshijnë: Testim, Kalibrim, Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë, Menaxhim Mjedisor, Inspektim, Certifikim Personeli, Certifikim Produkti, etj.

Harmonizimi i sistemit të akreditimit dhe njohjes nuk është vetëm një kërkesë e Bashkimit Europian diktuar vendeve anëtare, por edhe një kërkesë në rritje e konsumatorit për produkte dhe shërbime cilësore dhe biznesit në mënyrë të vecantë e asaj pjesë që kërkon të veprojë në tregun e europian. Pikërisht vlerësimi i kompetencës teknike të një laboratorit behet mbi baze kritere bazuar në standardet dhe udhëzuesit përkatës. Në këtë mënyrë mekanizimi i njohjes kërkon që produkti apo shërbimi të përputhet me kërkesat specifike që kanë të bëjnë me sigurinë. Akreditimi është njohur si një rrugë efektive për reduktimin e barrierave teknike në tregëti në Europë dhe më gjerë duke ju siguruar, në këte mënyrë, biznesit lehtësira në eksportin e produkteve dhe shërbimeve të tyre në tregun europian dhe atë ndërkombëtar. Kjo, pasi organizmat e akreditimit veprojnë sipas të njëjtave standarde europiane dhe ndërkombëtare. Gjithashtu procesi i akreditimit, ose njohjes, konfirmon përputhjen me specifikimet e përcaktuara nga standardet ndërkombëtare dhe ato europianesi dheredukton risqet. Në kushtet kur, në Shqipëri, institucionet që merren me matje rrezatimesh, kalibrim, trajnime, dozimetri personale nuk kanë akreditime persa i perket elementëve të përshkruara më sipër, është e domosdoshme një njohje në nivel të pranueshëm persa i takon matjeve që ato kryejnë. Këto shërbime njihen nga ana e KMR mbi bazën e disa elementeve bazë që janë të përcaktuar më poshtë.

Kjo do të sigurojë një element teknik dhe juridik të përshtatshëm për kryerjen e veprimtarive nga ana e këtyre kompanive.

Kriteret që duhen plotësuar për njohje nga ana e KMR:

KALIBRIM TË PAJISJEVE RADIOMETRIKE DHE MATËSE TË RREZATIMEVE

- Laborator
- Pajisje të përshtatshme
- Metodikat e Matjeve
- Reference Primare nga Laborator i Akredituar
- Kapacitete njerezore te kualifikuara
- Akreditim (opsional)
- Arkiv

MATJE ME RREZATIMET JONIZUESE DHE JOJONIZUESE

- Pajisje
- Metodike Matjesh
- Kapacitete Njerezore, Trajnim
- Procedurat për kontrollin e cilësisë
- Procedurat e operimit standart
- Laborator
- Arkiv , Bazë të dhënash

TRAJNIME

- Program Trajnimi, materiale tekst,
- Kapacitete Njerezore
- Ambjent Mësimi dhe Praktike
- Arkiv

SHËRBIM I DOZIMETRISË PERSONALE

- Pajisje të dedikuara për matje
- Karta leximi
- Metodikë
- Procedura të kontrollit të cilësisë
- Procedura të operimit standart
- Personel të trajnuar
- Arkiv
- Akreditim (Opsional)

Për vlerësimin e personave juridike e fizike që kërkojnë njohje nga ana e KMR-se, inspektoret e ZMR-së bëjnë verifikimin dhe paraqesin në KMR një vlerësim me shkrim për gjendjen e kompanisë në lidhje me kriteret dhe KMR vendos në lidhje me njohjen. Personave juridikë e fizikë që plotesojnë kriteret për njohje, pas miratimit nga ana e KMR-së, u leshohet një dokument njohje sipas formatit të mëposhtëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET

Ç E R T I F I K A T Ë K O N F O R M I T E T I
(NJOHJE)

Nr. _____ Datë _____

KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET

NE MBLEDHJEN E KMR ,

Nr _____ DATË, _____ Njeh

Emri i Subjektit : _____

Përfaqësuar nga : _____

PËR TË KRYER VEPRIMTARITË E MËPOSHTËME :

SEKRETARI

KRYETARI

